



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.25, datë 26.02.2026

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR 13, DATË 28.01.2026 PËR MIRATIMIN NË PARIM TË LISTËS TË FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANIMIT TË BANESAVE EKZISTUESE”.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 26.02.2026, mori në shqyrtim projektaktin e bështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin Social”, VKM nr.454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM nr.458, datë 03.07.2019, VKM nr.823, datë 18.12.2019, VKM nr.301, datë 15.04.2020, VKM nr.579, datë 22.07.2020, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.33, datë 26.08.2020, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.31, datë 18.11.2019, Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, miratuar me VKM nr.405, datë 01.06.2016, si dhe VKB-së nr.13, datë 28.01.2026 “Për miratimin në parim të listës së familjeve që përfitojnë nga programi për përmirësimin e kushteve të banimit të banesave ekzistuese”

**VENDOSI:**

Në vendim nr 13, datë 28.01.2026, të Këshillit të Bashkisë Skrapar, në listen bashkëlidhur këtij vendimi, numri rendor 24, ku përcaktohet “Banesë (zyra e Shoqatës së të Verbërve), zvendësohet me të njejtin numër rendor , me emrin Namik Lame.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër – s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elsa PETRITAJ**

